

## Bamirësi përnjëmend apo tregti me varfërinë?

Nuk ka asnjë fe, as edhe feja jonë islame, e cila në mësimet qenësore të saj të mos e trajtojë çështjen e bamirësisë, të kujdesit dhe të mirësjelljes ndaj nevojtarëve, fukarenjve dhe hallexhinjve. Madje nuk e di a do të mund të quhej fe ajo e cila nuk kërkon zgjatjen e dorës për këtë kategori njerëzish. Ndoshta, ideologji pasanikësh, me emra të ndryshëm, ama fe sigurisht që nuk do të quhej. Si një element thelbësor i fesë, bamirësia me të gjithë emrat dhe format e saj, është kërkesë e drejtpërdrejtë e fesë, me të cilën mëtohet krijimi dhe ruajtja e kohezionit në shoqëri.

**Varfërinë** mund ta përkufizojmë si mungesë të të mirave materiale me të cilat mbulohen nevojat elementare të njeriut ose të familjes. Ajo ka nivelet e veta, që nga njeriu i pastrehë që nuk zotëron asgjë e deri tek ata që të ardhurat nuk ua mbulojnë harxhimet e tyre mujore. Sot shtetet bashkëkohore kanë parametrat e vetë për matjen e varfërisë si dhe të përcaktimit të kufijve të saj. Varfëria ka shkaqet dhe faktorët e vet, si ata ekonomikë, shoqërorë, politikë por edhe kulturorë dhe fetarë. Tani nuk do të hyjmë më thellë këtu. Mirëpo dëshirojmë shkurt t'i paraqesim **qasjet** më të rëndësishme ndaj varfërisë, në të kaluarën dhe sot, sepse janë me rëndësi për temën që po e trajtojmë: **1. Varfëria është diçka e shenjtë.** Këtë qasje ndaj varfërisë e kanë pasur disa asketë e murgj, nga të gjitha fetë. Sipas tyre, varfëria nuk është një gjë e keqe së cilës duhet shmangur, porse ajo është një dhunti e Zotit, me të cilën Ai e ka begatuar atë që Ai e do. Po sipas tyre, pasuria dhe zengjijnllëku vetëm se të prishë, të korrupton e të largon nga vlerat shpirtërore dhe përfundimisht nga Zoti. **2. Varfëria është fat, kësmet, e determinuar.** Këta varfërinë e konsiderojnë si të keqe e të padëshirueshme, mirëpo pretendojnë se asaj nuk mund t'i iket dhe se njeriu duhet të pajtohet me fatin e vet. Atë nuk mund ta largojë asgjë. Edhe varfëria edhe zengjijnllëku janë të shkruara nga lart, nga Zoti, dhe se duhet të pajtohemi me këtë realitet. Sikur të kishte dashur Zoti, do t'i kishte bërë të gjithë njësoj të pasur, por jo, Ai ka vendosur ndryshe. Ai ka dashur që disa t'i dallojë mbi disa të tjerë dhe i ka sprovuar me pasuri, ndërsa të tjerët me varfëri. Zgjidhja? Të varfrit duhet të pajtohen me gjendjen e tyre dhe të jenë të durueshëm, pasi pajtueshmëria dhe modestia janë "pasuri" të pashtershme. Këta nuk u thonë asgjë pasanikëve, sepse ky është edhe fati i tyre – të jenë të pasur. Këta u drejtohen vetëm fukarenjve me këshilla duke u thënë: "Kjo është dëshira dhe vullneti i Zotit, prandaj jini të durueshëm, kënaquni me atë pak që keni dhe mos kërkonit më shumë se kaq, mos u mundoni ta ndryshoni vullnetin e Zotit." **3. Bamirësia është punë vullnetare dhe individuale.** Këta varfërinë e shohin si diçka të keqe, të padëshirueshme, si një problem që kërkon zgjidhje. Sipas tyre, pasanikët duhet të jenë më dorëlibër, më bujarë e më bamirës ndaj të varfërve, por kjo mbetet në përgjegjësinë personale të tyre. Nëse e bëjnë këtë, do të shpërblehen nga Zoti, e nëse jo, do të ndëshkohen nga Zoti. Këta nuk parashohin ndonjë nivel më të lartë, më konkret, më serioz, më të organizuar e më të strukturuar të bamirësisë. **4. Varfëria është zgjedhje personale e të varfrit.** Sipas tyre, varfëria është e keqe, e padëshirueshme, por për këtë fajtor është vetë personi ose familja e varfër, eventualisht fati ose fatkeqësia e tyre në jetë, por jo shoqëria apo shteti. Sipas tyre, fukarenjtë janë dembelë që nuk duan të punojnë, janë shkapërdarë që nuk dinë të kursejnë, janë parazitë që janë mësuar të jenë të varur nga të tjerët etj. Kjo teori më së miri shihet në profilin e Karunit në kohën e Musait a.s. si dhe te politeistët e Mekkes të cilët thoshin: "... a ne t'i ushqejmë ata që, po të kishte dashur

*Zoti, do t'i kishte ushqyer Vetë...?*" (Jasin, 36:47). Sipas këtyre, mjafton që shoqëria t'u ofrojë këtyre mundësinë për të fituar dhe për t'u pasuruar, tjetra ngelet në dorën e individëve të shoqërisë: kush është i zoti dhe punëtor, ai përpiqet, fiton dhe pasurohet, në të kundërtën mbetet i varfër. **5. Varfëria është pasojë e vjedhjes së pasurisë nga ana e pasanikëve, borgjezëve.** Ajo mund të eliminohet vetëm duke e sulmuar klasën e pasanikëve, duke e konfiskuar pronën dhe pasurinë e tyre dhe duke ia dorëzuar klasës së shtypur, të varfërve, proletariatit, ose në rastin më radikal, duke e shfuqizuar të drejtën e pronës private.

Qasja e fesë islame ndaj varfërisë dhe skamjes. Duke i shikuar një nga një qasjet e mësipërme, dikush mund të mendojë se secila prej tyre pak a shumë është qasje islame. Mirëpo, shikuar nga këndvështrimi i plotë i mësimave islame, mund të themi se: **1. Islami e refuzon idenë se varfëria është diçka e shenjtë.** Asnjë ajet kur'anor dhe asnjë hadith i Muhammedit a.s. nuk e lavdëron, e aq më pak ta shenjtërojë varfërinë. Po, ato e lavdërojnë të varfrin dhe i japin moral e vullnet atij – si p.sh. hadithi i Muhammedit a.s. se "*fukarenjtë do të hyjnë shumë më herët në Xhennet sesa pasanikët*" -, por nuk e lavdërojnë dhe nuk e madhërojnë varfërinë. Ky është një dallim i madh që nuk duhet anashkaluar. Mësimet islame që po ashtu e lavdërojnë dhe e kërkojnë maturinë e modestinë, nuk nënkuptojnë asses lavdërimin e varfërisë. Të parat janë virtyte, kurse varfëria është një e keqe e madhe si për individin ashtu edhe për shoqërinë, si për fenë ashtu edhe për moralin, si për mendimin ashtu edhe për kulturën; varfëria është një e keqe që duhet të çrrënjohet dhe për të cilën Pejgamberi a.s. ka kërkuar mbrojtje tek All-llahu xh.sh. prej saj. Muhammedi a.s. ka thënë: "*Varfëria gati sa nuk të çon në mosbesim (kufër).*" (Ebu Nuajmi) dhe "*O All-llahu, kërkoj mbrojtje dhe strehë te Ti nga varfëria, nga hallet, nga nënçmimi dhe nga padrejtësia ndaj meje dhe ndaj tjetrit!*" (Ebu Davudi & Ibni Maxhe), **2. Islami e refuzon idenë se varfëria është e shkruar nga Zoti, fat i njeriut të varfër.** Në sa e sa ajete kur'anore All-llahu xh.sh. kërkon nga pasanikët që t'u ndihmojnë të varfërve, pasurinë dhe të mirat e tjera me të cilat i ka begatuar Zoti, t'i ndajnë me nevojtarët dhe hallexhinjtë. Të ishte varfëria e shkruar nga Zoti, Ai nuk do të kërkonte ndërhyrjen në këtë çështje dhe përmirësimin e gjendjes së fukarenjve. E sjellim të plotë ajetin 47 të sures Jasin (36): "*Dhe kur u thuhet: 'Jepuni (fukarenjve) nga ajo me çka ju ka begatuar All-llahu!', ata që nuk besuan, besimtarëve u thonë: 'A ne t'i ushqejmë ata që, po të kishte dashur Zoti, do t'i kishte ushqyer Vetë?! Ju nuk jeni gjë tjetër, vetëm se të humbur qartë!'*". Nga ana tjetër, as Muhammedi a.s. nuk do të lodhej duke u ndihmuar vetë të varfërve sikur fukarallëku të ishte caktim dhe kësmet i pandryshueshëm i Zotit. **3. Islami e refuzon idenë se bamirësia është vetëm një akt vullnetar dhe personal.** Po të shikohet në plotësinë e mësimave islame, do të vërejmë se bamirësia në Islam nga njëra anë është obligim dhe detyrë e pasanikut, nga ana tjetër është e drejtë (*hak*) e varfanjakut. Aty ku kemi të bëjmë me obligime dhe të drejta, aty është i domosdoshëm automatikisht ekzistimi dhe intervenimi i shtetit dhe i organeve të tij, në mënyrë që me efikasitet të kryhen detyrat dhe të realizohen të drejtat. Kur'ani fisnik thotë: "*... në pasuritë e tyre (të pasanikëve) ka pjesë (hise, hak, të drejtë) lypësi dhe nevojtar.*" (edh-Dharijat, 51:19; el-Me'arixh, 70:24-25). Prandaj, sipas mësimave islame, bamirësia, solidariteti dhe ndarja e të mirave me të varfrit nuk është thjesht një virtyt personal i pasanikut, që varet nga disponimi, humori, qejfi, empatia dhe dhembshuria e tij e rastit, por ajo njëkohësisht është obligim i tij, por edhe e drejtë e nevojtarit. Pikërisht këtu lind edhe nevoja e pamohueshme dhe e pashmangshme, se varfëria në radhë të parë duhet të shkulet e të çrrënjohet me dorën e shtetit, e pastaj me dorën e organizatave humanitare dhe krejt në fund të individëve bamirës, **4. Islami e refuzon idenë se pasurinë që e zotërojnë pasanikët është pronë absolute e tyre.** Sipas mësimave islame, njeriu nuk është pronari i vërtetë i pasurisë së tij, ai është vetëm zotërues i përkohshëm i saj. Pronari i vërtetë është All-llahu xh.sh. Prandaj është shumë interesante të përmendet se në Kur'an, sa herë që përmendet detyra e dhënies dhe e bamirësisë, kërkohet që kjo të

bëhet nga ajo që pasanikut i është dhënë nga Zoti. Ja një shembull: *"O ju besimtarë, jepni (dhuroni) nga ajo me çka ju kam furnizuar Unë!..."* (el-Bekara, 2:254). Këtu nuk u tha Zoti besimtarëve pasanikë që të japin nga ajo që e kanë krijuar, shpikur ose fituar vetë me zotësinë, inteligjencën a elanin e tyre, por nga ajo që e kanë në dorë si amanet nga Zoti. Krejt kjo paralel me premtimin se nëse shpërndajnë edhe për nevojtarët, kjo pasuri e tyre vetëm se do të shtohet edhe më shumë dhe me garancinë se bamirësi asnjëherë nuk do të dobësohet apo varfërohet duke dhuruar. Përskaj kësaj, nuk mjafton vetëm të pretendosh se në një shoqëri të hapur ka barazi shansesh për secilin që dëshiron të angazhohet, të punojë e të pasurohet. Sepse jo të gjithë kanë arsimimin e njëjtë, jo të gjithë e kanë shëndetin e njëjtë, jo të gjithë e kanë moshën e njëjtë vitale për të punuar, andaj çka mund të bëjë në një shoqëri të hapur një fëmijë jetim, një grua e vejë, një i sëmurë rëndë, një i moshuar që s'mund të punojë?! Këtu, edhe një herë më tepër, e theksojmë dorën e fuqishme të shtetit me të gjitha pushtetet dhe aparaturën e tij në mbështetje të këtyre nevojtarëve; e nënkuptojmë edhe domosdoshmërinë e mbledhjes së tatimeve me dorë shteti, pa e dëmtuar kreativitetin dhe konkurrencën e tregut; e nënkuptojmë edhe krijimin e fondeve apo sigurimeve të ndryshme sociale për të mbështetur njerëzit në nevojë. Shtetet me demokraci e liberalizëm të konsoliduar mirë, sot i gjen të jenë edhe shtetet më sociale, që lirisht mund të themi se veprojnë në frymën e plotë të mësimave islame, përkundër atyre që vetëm pretendojnë se janë shtete islame, **5. Islami e refuzon idenë se pasanikëve duhet t'u uzurpohet pasuria dhe se askush të mos ketë të drejtë në pronë private, gjithçka të jetë pronë publike në dorë të shtetit.** Ndër të drejtat dhe liritë elementare të njeriut sipas mësimave islame bën pjesë edhe e drejta apo liria e pronës private. Islami e garanton këtë dhe e mbron fuqishëm. Islami nuk del kundër të gjithë pasanikëve, vetëm për arsye të disa pasanikëve të pandërgjegjshëm. Ai kërkon mbrojtjen e pasurisë së secilit, kërkon fitimin hallall e jo në kurriz të tjetrit dhe kërkon solidarizim mbi bazën e vëllazërisë midis shtresave të ndryshme shoqërore. Islami jo që nuk e kërkon, ai as edhe nuk e lejon, luftën dhe armiqësinë midis të varfërve dhe pasanikëve. Ai kërkon, siç thamë, bashkëpunimin, bashkëveprimin dhe bashkëjetesën midis tyre në bazë të një vëllazërie të gjithmbarshme. Ai nuk pranon zgjidhjen e një problemi duke krijuar një problem akoma më të madh. Në kohën e Muhammedit a.s. për shembull kanë jetuar shokë të pasur të tij, siç ishin Abdurrahman bin Aufi, Osman bin Affani e të tjerë, të cilët nga pasuria e madhe e tyre që kishin, nuk i kursenin aspak nevojtarët, madje ata ishin edhe mbështetësit dhe kontribuesit më të mëdhenj jo vetëm të tyre, por edhe të mbarë shtetit.

Shkurt thënë, Islami i shpall luftë varfërisë, ai ka proklamuar masa të fuqishme për mënjanimin e efekteve negative të saj për individin, për shoqërinë, për fenë, moralin etj. Islami kërkon që secili anëtar i shoqërisë të zotërojë atë më të nevojshmen për një jetë dinjitoze, në të cilën do të mund të plotësohen nevojat elementare të njeriut. Islami këtë e arrin me anë të këtyre mjeteve dhe metodave: punës, angazhimit të pasanikëve për t'u kujdesur për familjarët e tyre, zeqatit, detyrimet e ndryshme materiale përveç zeqatit si sadakaja, kurbanit etj., dorës së shtetit me të gjitha mundësitë e tij, bamirësia individuale dhe kolektive etj.

Nga sqarimet e mësipërme mund të kuptojmë se çrënjosja ose zbutja e varfërisë së një shoqërie në radhë të parë është përgjegjësi kolektive, e shtetit dhe e institucioneve të tij, pastaj e shoqërisë me të gjitha strukturat e saj të mundshme dhe në fund edhe e çdo një individi, sipas mundësive të tij.

Me sa thamë më lart, ndarja e të mirave me nevojtarët sa është detyrë e pasanikëve, po aq është edhe e drejtë e nevojtarëve. Pikërisht, për ta ruajtur kohezionin dhe vëllazërinë e vërtetë midis njerëzve të shtresave të ndryshme sociale e ekonomike, Islami përcakton

edhe disa rregulla se si do të duhej të zhvillohej përcjellja e këtyre të mirave nga pasanikët te nevojtarët, qoftë kjo të bëhet nga ana e individëve, qoftë nga ana e organizatave humanitare apo edhe nga vetë shteti.

Ndër **detyrat kryesore** ndaj të varfërve dhe nevojtarëve janë, sipas radhës:

**1. Trajtimi i varfanjakëve si njerëz të barasvlershëm me ne.** Shumëkush do të kishte thënë se detyra e parë do të ishte dhurimi i mjeteve materiale. Përkundrazi, Islami na mëson që ndaj çdokujt të sillemi në mënyrën më të mirë, më të bukur e më dinjitoze të mundshme. Duke qenë se nevojtarit vetëm se është duke vuajtur për shkak të mungesës së të mirave bazë për një jetë me dinjitet, ai duhet të kujdeset tani edhe për atë se si do ta shtrijë dorën. Kjo është një vuajtje e dyfishtë për të. Pikërisht për këtë, prej bamirësit kërkohet që gjatë takimit me të varfrin, të mos e trajtojë atë si më pak të vlefshëm, si më pak njeri; të mos e shikojë atë me nënçmim, me sy të keq dhe me përbuzje. Është e vërtetë se atij i mungojnë të mirat materiale, mirëpo ai e ka dinjitetin, nderin, vlerën, njerëzinë, moralin etj. Madje, në disa raste, këto vlerat e tjera ai mund t'i ketë më shumë sesa vetë bamirësi. Prandaj, nga bamirësi kërkohet që varfanjakun ta takojë me fytyrë të qeshur e t'i flasë fjalë të mira, duke mos i dhënë asnjëfarë shenje për varfërinë e tij. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: *"Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqinjit të afërt, ndaj fqinjit të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet."* (en-Nisa', 4:36) Po ashtu në suren el-Bekara (2), ajeti 83 thotë: *"...mos adhuroni tjetërkë përveç All-llahut, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj miskinëve (të varfërve) dhe njerëzve thuajuni fjalë të mira..!"* Ndërkaq Muhammedi a.s. ka thënë: *"Mos e shihni të vogël e të pavlefshme asnjë mirësi, bile as edhe takimin e njerëzve me fytyrë të qeshur!"* (Muslimi)

**2. Ofrimi i mbështetjes shpirtërore.** Pas takimit dhe trajtimit dinjitoz të nevojtarit, vjen rritja e moralit, e vullnetit të tij për vazhdimin e jetës, duke ia bërë me dije atij se të mirat materiale nuk janë gjithçka, se pasuria e vërtetë është pasuria e zemrës, është besimi, është karakteri, është sjellja e mirë, është familja, është miqësia, se pasuria materiale vjen dhe shkon, se pasuria materiale sot është në dorë të një zengjini e nesër kalon në dorë të varfanjakut të sotëm, se hallet janë të përkohshme etj. I përkujtohet atij hadithi i Muhammedit a.s.: *"Pasuria e vërtetë nuk është të kesh shumë mall e gjësende, porse pasuria ose zengjinnllëku i zemrës, i shpirtit"* (Buhariu dhe Muslimi).

Krejt kjo mbështetje shpirtërore e morale ndaj varfanjakut bëhet me motive fetare, kur'anore dhe të Muhammedit a.s. All-llahu xh.sh. në Kur'an na porosit: *"Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e në armiqësi..!"* (el-Maideh, 5:2). Një njeri erdhi një ditë te Muhammedi a.s. dhe e pyeti: *"O i Dërguar i Zotit, cili njeri është më i dashur tek All-llahu dhe cila vepër është më e dashur tek All-llahu?"* Muhammedi a.s. iu përgjigj: *"Njeriu më i dashur tek All-llahu është ai që është më i dobishëm për njerëzit, ndërsa vepra më e dashur tek All-llahu është gëzimi që ia bën njeriut, ose largimi i një halli a derti të tij, ose larja e borxhit të tij, ose largimi i urisë dhe etjes së tij. Për mua, më të vërtetë, më e dashur është që ta shoqëroj një vëlla (njeri) në plotësimin e një nevoje të tij sesa të mbyllem një muaj në i'tiqaf (izolim vullnetar në xhami për ibadet në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit)."* (Taberaniu) Të jesh njeri i dashur tek All-llahu, sipas një hadithi të Muhammedit a.s., nuk është aspak punë e vogël dhe e pavlerë. Thotë Muhammedi a.s.: *"Kur All-llahu e do një njeri, e thërret melekun Xhebrail dhe i thotë: 'Unë e dua filanin, dua je edhe ti!' Xhebraili e do atë dhe u drejtohet banorëve të qiellit (melekëve) duke u thënë: 'All-llahu e do filanin, duajeni edhe ju!' Edhe melekët e tjerë e duan atë po ashtu. E pastaj All-llahu atë njeri e bën të pranueshëm dhe të dashur edhe për banorët e tokës..."* (Buhariu). Në një hadith tjetër

Muhammedi a.s. thotë: *"All-llahu do ta ndihmojë atë njeri, i cili i ndihmon vëllait të vet (një njeriu tjetër)."* (Hakimi)

**3. Ofrimi i mbështetjes materiale.** Vetëm pasi ta kemi trajtuar varfanjakun si të barasvlershëm me ne dhe me plot nder e respekt, dhe vetëm pasi ta kemi mbështetur atë shpirtërisht, hapi i tretë është ta mbështesim edhe me gjëra materiale e me gjësende të tjera, për të cilat ka nevojë ai. Mbështetja materiale pa dy hapat paraprakë, do të ishte shumë e thatë dhe si të thuash arrogante, nënçmuese e përbuzëse. Motivet për ta ndihmuar të ngratin dhe nevojtarin janë fetare dhe njerëzore. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: *"O ju që keni besuar, para se të vijë një ditë (Kijameti) kur nuk do të ketë as shitblerje, as miqësi, e as ndërmjetësi, jepni nga ajo me çka Ne ju furnizuar juve!"* (el-Bekara, 2:254). Ai po ashtu thotë: *"Dhe jepni nga ajo që Ne ju kemi dhënë juve, para se ndonjërit prej jush t'i vijë vdekja, e atëherë të thotë: 'O Zoti im, përse nuk më shtyve edhe pak afatin (e vdekjes), që të jepja lëmoshë e të bëhesha prej bamirësve!"* (el-Munafikun, 63:10). Ndërsa Muhammedi a.s. ka thënë: *"Çdo e mirë është sadaka. Vërtet, nga veprat e mira është ta takosh me fytyrë të qeshur vëllanë tënd dhe të derdhësh atë që ka mbetur në kovën tënde në enën e vëllait tënd."* (Ahmedi dhe Tirmidhiu) Muhammedi a.s. ia tërheq ashpër vërejtjen pasanikut që rri indiferent ndaj nevojtarëve dhe të ngratëve që i ka përreth vetes, duke thënë: *"Nuk është besimtar (i vërtetë) ai i cili është i ngopur, ndërsa fqinji i tij vuan nga uria!"* (Hakimi).

Kur është në pyetje bamirësia, duhet të jetë e qartë se prej nesh nuk kërkohet ta shpenzojmë tërë pasurinë për nevojtarët. Shpenzimi i obligueshëm, zeqati, është 2.5 % nga kursimet njëvjetore, kurse sadakaja (lëmosha vullnetare) nuk ka kufi, kjo varet nga mundësia që kemi ne si dhe nga bujaria dhe zemërgjerësia jonë. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: *"Të pyesin ty (o Muhammed) se çfarë (sa) të dhurojnë? Thuaju: 'tepricën'"* (el-Bekara, 2:219). Muslimani pasanik fillimisht duhet të jetë mirënjohës që është pasanik, zengjin. Ka mundësi të ketë qenë, ose në të ardhmen të bëhet, nevojtar e i ngratë. Mënyra e plotë e falënderimit dhe e mirënjohjes për pasurinë bëhet me fjalë që dalin nga zemra drejtuar Zotit, pastaj duke e vlerësuar dhe kultivuar atë që e zotëron si dhe duke ndarë me nevojtarët aq sa ka mundësi. Besimtari është i bindur plotësisht dhe paluhatshëm në bujarinë e pafund të All-llahut xh.sh. Ai e di se All-llahu xh.sh. ishte Ai që ia dhuroi pasurinë dhe po Ai është që i premtun në Kur'an se po shpenzoi nga ajo që i ka dhuruar Ai, do t'ia shtojë e bekojë atë shumëfish në këtë botë, por edhe në botën tjetër. Ai në Kur'an thotë: *"Dhe përkujtoni kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: 'Nëse jeni falënderues, do t'ju shtoj të mirat...'"* (Ibrahim, 14:7). Ndërsa Muhammedi a.s. ka thënë: *"Asnjë sadaka nuk e pakëson pasurinë (e dhuruesit)..."* (Muslimi). Ai po ashtu ka thënë në një hadith tjetër: *"Ju betohem për tri gjëra, mbani mend mirë! E para, asnjë sadaka nuk do ta pakësojë pasurinë (e atij që dhuron). E dyta, All-llahu do t'ia shtojë nderin dhe madhësitinë atij që i është bërë padrejtësi dhe ky duron (ia lë këtë në dorë Zotit). E treta, kushdo që e hap derën e lypësisë, All-llahu do t'ia hapë atij derën e varfërisë (fukarallëkut)."* (Ahmedi). Në një hadith tjetër këtij akti i jepet një dimension tej-hapësinor: *"Për çdo ditë dy melekë zbresin në tokë dhe i luten Zotit. Njëri melek lutet: 'O All-llah, kompensoja dhe shtoja atij që jep!' Kurse tjetri: 'O All-llah, fshija pasurinë atij (që ka mundësi të japë dhe) nuk jep!'"* (Muslimi).

Disa rregulla që duhet t'i ketë parasysh bamirësi me rastin e ofrimit të mbështetjes materiale për nevojtarët:

**3.1. Bamirësia të bëhet për hir të Zotit dhe shpërblimi të pritët vetëm nga Ai.** Muslimani pasanik që e ka arritur këtë gradë të përkushtimit ndaj Zotit, nuk pret prej atyre që u ndihmon asgjë si kundërshpërblim, nuk pret as edhe falënderim prej tyre. Në Kur'anin fisnik All-llahu xh.sh. i lavdëron të këtyllët dhe u premtun: *"(Në Xhennet do të pinë nga gota një përzierje me kamfur) ata që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër (duke u thënë): 'ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej"*

*jush nuk kërkojmë ndonjë kundërshpërblim e as falënderim''' (el-Insan, 76:5, 8-9). Ai po ashtu në Kur'an premtan: "Çkado që të jepni nga pasuria juaj, e keni për vete. Por mos jepni për tjetërkë, pos se për hir të All-llahut. E çkado që t'u jepni të tjerëve nga pasuria juaj, ajo do t'ju kompensohet në mënyrë të plotë, pa u dëmtuar ju aspak." (el-Bekara, 2:272).*

**3.2. Të gjurmohen e të gjenden nevojtarët e vërtetë.** Gjithmonë ka pasur njerëz të cilët lypësinë e kanë bërë profesion, zanat. Sot madje mund të flitet edhe për «industrinë e lypësisë». Nuk është bamirësi t'u ndihmohet njerëzve të këtillë. Për këtë do të flasim më poshtë. Prandaj, në raste të këtilla është shumë me rëndësi që të gjurmohen nevojtarët dhe të ngratët e vërtetë, të cilëve u vjen turp ta shtrijnë dorën dhe të lypin. Ndërgjegjja dhe dinjiteti i tyre nuk ua lejon këtë. Prandaj, secili musliman pasanik, në vend që të japë në vende të gabuara duke menduar se po bën mirësi, duhet të interesohet vetë t'i gjejë nevojtarët e vërtetë në lagjen, fshatin ose në vendbanimin e vet. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: *"(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët, të angazhuar në rrugën e Zotit nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Pasi që ata janë modestë e nuk lypin, ai, që nuk i njeh ata, kujton se janë pasanikë. I njeh ata nga fizionomia e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, All-llahu i di ato." (el-Bekara, 2:273)* Kjo lidhet edhe me pikën 3.4. më poshtë.

**3.3. Bamirësia të mos bëhet me gjësende që janë të pavlera e të dala nga përdorimi.** Për fat të keq, shumë njerëz priren të bëjnë kinse bamirësi, duke i shpenzuar gjërat që nuk i përdor më as vetë e as familja e tij, gjëra të stërvjetëruara dhe të pavlerë. Kjo është e turpshme në vetvete dhe turpëruese në të njëjtën kohë. Njeriu, edhe këtu, duhet të bëjë pak empati: a do ta kishe pranuar ti me vetëdije një gjë të tillë për vetveten ose për familjen tënde?! Për një empati të këtillë ne na thërret edhe All-llahu xh.sh. në Kur'an: *"O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që ju dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranoni për vete pos symbyllazi. Dijeni se All-llahu nuk ka nevojë për ju, ngase është i Madhëruar." (el-Bekara, 2:267).* All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë po ashtu: *"Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë me besim (as kënaqësinë e lumtur në Xhennet) derisa të mos e jepni më të dhimbshmen (më të dashurën) e pasurisë suaj. Çkado që jepni (për Zotin), All-llahu atë e di." (Alu Imran, 3:92)* Këtu përjashtim bëjnë sendet e reja që i kemi blerë për vete a për familjen dhe të cilat nuk i kemi përdorur fare ose shumë pak – për fat të keq; ato i kemi nxjerrë nga përdorimi vetëm pse nuk janë në modë më. Këto, që janë të përdorshme akoma, mund të dhurohen dhe është më mirë të dhurohen sesa të gjuhen në bërlllog.

**3.4. Bamirësia të mos bëhet me kryelartësi si dhe të ruhet privatësia, nderi dhe dinjiteti i nevojtarit.** Edhe pse është e lejuar që mirësia të bëhet haptazi, më e mira e së mirës është që ajo të bëhet fshehurazi. Ky është një postulat që e gjejmë pothuajse te të gjitha fetë, të shprehur në sintagmën «të mos e dijë dora e majtë çfarë jep dora e djathtë!». All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: *"Nëse lëmoshat i jepni haptazi, ajo është mirë, por nëse ato ua jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju dhe Ai jua largon të këqijat. All-llahu është i njohur hollësisht për veprat tuaja." (el-Bekara, 2:271)* Bamirësia e pasanikut nuk guxon ta shpalosë privatësinë e nevojtarit; ajo nuk guxon ta lëndojë nderin, dinjitetin dhe sedrën e nevojtarit. Bamirësia duhet të shërojë plagë, e jo të hapë plagë të tjera edhe më të mëdha. Këtë të dytën e urren çdokush, si Zoti, ashtu edhe melekët dhe njerëzit. Për këtë All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: *"Ata që për hir të All-llahut e japin pasurinë e tyre, e pastaj atë që e dhanë nuk e përcjellin me të përmendur e me mburrje, ata e kanë shpërblimin e vet të Zoti i tyre, për ta nuk ka frikë, ata as që do të brengosen. Një fjalë e mirë dhe një lehtësim (që i bëhet lypësit) është më e mirë se një lëmoshë që përcillet me të keqe. All-llahu nuk ka nevojë për askë, është i Butë. O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa par sy e faqe të njerëzve, e nuk*

*beson All-llahun dhe botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar mbi të cilin ka pak dhé, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. All-llahu nuk e udhëzon popullin pabesimtar (që ka vendosur të mos udhëzohet). E shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre e duke kërkuar kënaqësinë e All-llahut, i përngjan një kopshti në një rrafshnaltë që i bie shi i madh, e ai jep fruta të dyfishtë. Po edhe nëse nuk i bie shi i madh, i bie një rigë (që i mjafton). All-llahu sheh atë që veproni." (el-Bekara, 2:262-265).*

Kur është në pyetje edukata e bamirësisë, në këto ajete janë kyçe dy fjalët: «menn» dhe «edha». Fjala arabe «menn» do të thotë: «t'ia përmendësh dikujt të mirën që ia ke bërë». Kjo është shumë e ulët. Paramendo si do të ndiheshe ti në qoftë se dikush të ka bërë mirë dhe ta përmend këtë vazhdimisht, sa herë që të takon?! Fjala e dytë është «edha», e cila në formë të shtrembëruar është futur edhe në të folmen popullore shqipe «izet» (nga arab. «edhijeh» dhe turq. «eziyyet»). Kjo fjalë nënkupton: «T'ia përmendësh përpara të tjerëve mirësinë që ia ke bërë ndokujt; ta vësh në siklet atë; ta dëmtosh, ta lëndosh, ta fyesh, ta shqetësosh...». Këto të dyja janë vese të njerëzve të këqij, që nuk e besojnë Zotin, që janë mynafikë (dyfytirësh) dhe të cilët çdo mirësi që ua bëjnë të tjerëve e kushtëzojnë me kundërpaguesë, me kundërçmim, me dëgjueshmëri dhe me nënshtrim. Këta harrojnë se të mirat që i kanë, në fakt u janë dhuruar nga Zoti. Harrojnë se bamirësia është obligim i pasanikut dhe e drejtë e nevojtarit. Ajetet e mësipërme na bëjnë qartë me dije se ajo që jepet në emër të Zotit, duke mos e shqetësuar nevojtarin në asnjë farë forme, i ngjanë një kopshti që jep fruta shumëfish; këtë sjellje e do All-llahu, e duan engjëjt, e duan njerëzit, e do nevojtarit. E kundërta i përngjanë një shkëmbi të mbuluar me pluhur ose me pak truall dhe kur bie një shi i rrëmbyeshëm e lanë truallin nga ai dhe e lë atë lakuriq. Po kështu, lakuriq, të pavlera e të neveritura mbeten bamirësitë që bëhen duke e shqetësuar dhe lënduar nderin dhe dinjitetin e nevojtarit. Ato nuk i do as All-llahu, as engjëjt, as njerëzit e as nevojtarët.

Një formë e praktikimit të kësaj sjelljeje sot, për fat të keq, bëhet edhe nga individë por edhe nga organizata fetare në emër të fesë. Të mahnitur pas mbështetjes financiare për arsye bamirësie (humanitare), që e mbledhin nga të tjerët duke abuzuar me ndjenjat e dhembshurisë së tyre, ata e harrojnë kërkesën fetare se duhet të ruhet e të respektohet privatësia e varfanjakëve. Nën pretekstin se ata duhet t'i arsyetojnë mjetet e tubuara në mënyrë publike dhe private, ata nuk ngurojnë të mos e shfaqin identitetin e fukarenjve dhe hallexhinjve; bile në të shumtën e rasteve ndihmesa kushtëzohet vetëm nëse nevojtarit apo hallexhiu pajtohet që të shfaqet në ekranin e individit ose organizatës bamirëse. Ata që e refuzojnë këtë shfaqje, nuk marrin gjë. Ky është një klasifikim i tmerrshëm, i turpshëm, johuman dhe jofetar i nevojtarëve nga ana e «bamirësve». Jo më kot jemi duke thënë se në këtë pikë kemi të bëjmë me dukurinë e «**tregtisë me varfërinë**». Në qoftë se tregtia është këmbim mallrash dhe shërbimesh, atëherë këtu kemi këmbim të mjeteve humanitare kundrejt shpalosjes së identitetit të hallexhiut; kemi ofrimin e ndihmës që e kanë dhuruar të tjerët pa kushtëzim – vetëm në besim, kundrejt shitjes së fytyrës së hallexhiut për ekranin e organizatës; shprehur në mënyrë akoma më vulgare: «ta jap ndihmën, ma jep fytyrën!». Një «tregti» shumë e turpshme, shumë e ulët, që nuk e përlligj asnjë parametër human e fetar. Pyesim, si do ta gëzojë shtëpinë, banesën ose ndihmën tjetër, çfarëdo qoftë ajo, individi dhe familjarët e tjerë – sidomos fëmijët, kur të jenë shfaqur tanimë në ekran fytyrat e tyre prej hallexhiu e nevojtarit? Me çfarë kompleksesh do të rriten fëmijët e nevojtarëve, identiteti i të cilëve është shfaqur pastër dhe pa shfytirim digjital në ekran?! Paramendo hallexhiu të jesh ti dhe fëmijët e tu! Paramendo fytyra jote dhe e fëmijëve të tu, si nevojtarë që jeni, të jenë publikuar haptazi në ekran! Sa përpunet kjo dukuri me ajetet dhe kërkesat e mësipërme të Zotit? Pikërisht

këtu parashtrohet pyetja: këta «bimirës» e respektojnë fjalën e Zotit apo e keqpërdorin atë për interesa personale e kolektive?

**4. Të mbështeten nevojtarët që në të ardhmen mundësisht vetë ta rregullojnë gjendjen e tyre.** Një prej keqkuptimeve të fesë dhe të mësimave fetare lidhur me këtë temë është bindja e shpërhapur gjithandej, se detyrë e pasanikëve është bamirësia, pa marrë parasysh se si do të lëvizë më tutje në jetë nevojtarit. Nuk duhet harruar se qëllimi final i bamirësisë (i zeqatit dhe i sadakasë) nuk është mbajtja e fukarenjve përgjithmonë fukarenj, por ngritja e tyre, nxjerrja e tyre nga gjendja e mjerimit ku ndodhen. Në qoftë se ne si shoqëri ata i mbajmë përgjithmonë të varfër, vetëm si një deponi ku mund ta hedhim zeqatin dhe sadakanë tonë, atëherë nuk e kemi kuptuar fare fenë dhe bamirësinë si virtyt. Këtu jemi shumë afër pikës, ku nga nevojtarët e vërtetë e të mirëfilltë të krijojmë lypsarë e parazitë të shoqërisë, njerëz të varur vetëm nga lëmosha e të tjerëve. Përkundrazi këtu, në mënyrë të përshkallëzuar, duhet të zbatohet kjo strategji: i ndihmohet nevojtarit, që ai t'i ndihmojë vetvetes, në mënyrë që ai të mos ketë nevojë përgjithmonë për ndihmën e të tjerëve, por të mëkëmbet dhe një ditë edhe ai të jetë në gjendje t'u ndihmojë nevojtarëve të tjerë. Ky duhet të jetë synimi final i bamirësisë.

Për fat të keq, në shoqëritë dhe vendet e korruptuara ka edhe njerëz jonjerëz, të cilët i keqpërdorin nevojtarët ose njerëzit me të ardhura të ulëta për të bredhur rrugëve me qëllim të lypjes së mjeteve financiare. Në fund të ditës, këtyre lypsarëve, ata ua mbledhin paratë e tubuara duke u lënë një përqindje të vogël, për të vazhduar të nesërmen njësoj sikur sot. Kjo mbase duhet të jetë mënyra e fitimit në mënyrën më të ulët njerëzore.

Islami e gjykon dembelizmin dhe lypësinë. Ai e kërkon punën, angazhimin dhe përpjekjen. Dijetarët islamë janë pothuajse unanimitë në pikën se lypësia është haram, e ndaluar fetarisht. Pikërisht për këtë All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: "*Në fletushkat e Musait është shënuar se njeriut i takon vetëm ajo që ka punuar vetë dhe se munda i tij do të shihet më vonë*" (en-Nexhm, 53:39-40). Ndërsa Muhammedi a.s. thotë: "*Askush asnjëherë nuk ka ngrënë gjë më të mirë sesa ajo që e ka fituar me duart e veta. Davudi, peygamberi i Zotit, ushqej nga puna që e bënte vetë.*" (Buhariu). Më tej Muhammedi a.s. e gjykon drejtpërdrejtë lypjen pa nevojë, kur thotë: "*Ta marrë dikush prej jush një litar dhe ta ngarkojë një krah me dru në shpinën e vet, është më mirë për të sesa ta shtrijë dorën dhe të lypë; e pastaj dikush i jep e dikush e refuzon.*" (Buhariu). Lypja pa shtrëngim të madh jetësor është nënçmim i vetvetes, humbje e fytyrës. Muhammedi a.s. thotë: "*Ai që lyp vazhdimisht prej njerëzve, në Ditën e Kijametit do të dalë para All-llahut i pa fytyrë!*" (Muslimi) Lypja lejohet vetëm në tri raste, ka thënë Muhammedi a.s.: nëse dikush ka hyrë në borxh (për nevoja elementare) dhe nuk arrin ta lajë borxhin; nëse dikujt i ka ndodhur një fatkeqësi dhe i është shkatërruar e gjithë pasuria që kishte, dhe në qoftë se dikush ka rënë në varfëri dhe për këtë ka më së paku tre persona që dëshmojnë se ky është vërtet i varfër. Kush nuk e ka ndonjërin prej këtyre arsyeve dhe vazhdon të lypë, ai është duke u ushqyer me haram (Muslimi).

Nuk quhet bamirësi t'u ndihmosh njerëzve që pa arsye ose me arsye të dobëta e shtrijnë dorën dhe lypin rrugëve. T'u ndihmosh këtyre nënkupton ta ndihmosh procesin e dembelizimit të shoqërisë dhe të krijimit të një shtrese shoqërore e cila vazhdimisht do të mbetet në këtë gjendje, bile me tendencë për zgjerim të mëtejshëm. Nuk mund të quhet sevap mbështetja me vetëdije e së keqes shoqërore.

Prandaj, nevojtarët dhe hallexhinjtë e vërtetë e me nder duhet t'i gjejmë ne vetë dhe duhet t'u futen duart nën sqetulla për t'i mëkëmbur për ecje të pavarur në jetë.



## **Përmbyllje**

Të gjitha fetë, sigurisht që edhe feja jonë islame, ndër mësimet bazë e kanë edhe bamirësinë. Kjo nënkupton ekzistimin e varfërisë, e cila i ka shkaqet e saj të ndryshme politike, ekonomike, kulturore, fetare etj.

Kur është në pyetje qasja ndaj varfërisë mund të themi se: 1. Islami e refuzon idenë se varfëria është diçka e shenjtë, 2. Islami e refuzon idenë se varfëria është e shkruar nga Zoti, fat i njeriut të varfër, 3. Islami e refuzon idenë se bamirësia është vetëm një akt vullnetar dhe personal, 4. Islami e refuzon idenë se pasurinë që e zotërojnë pasanikët është pronë absolute e tyre, 5. Islami e refuzon idenë se pasanikëve duhet t'u uzurpohet pasuria dhe se askush të mos ketë të drejtë në pronë private, gjithçka të jetë pronë publike në dorë të shtetit.

Feja islame çrrënjosjen e varfërisë e parasheh me anë të këtyre mjeteve dhe metodave: punës, angazhimit të pasanikëve për t'u kujdesur për familjarët e tyre, zeqatit, detyrimet e ndryshme materiale krahas zeqatit si sadakaja, kurhani etj., dorës së shtetit me të gjitha mundësitë e tij, bamirësia individuale dhe kolektive etj.

Përgjegjësinë kryesore për këtë e bart shteti, pastaj shoqëria e gjerë dhe secili individ veç e veç.

Islami parasheh disa rregulla bazë kur është në pyetje bamirësia dhe raporti dhurues-nevojtar. Ndër detyrat kryesore ndaj të varfërve dhe nevojtarëve janë, sipas radhës: 1. trajtimi i varfanjakëve si njerëz të barasvlershëm me ne, 2. ofrimi i mbështetjes shpirtërore, 3. ofrimi i mbështetjes materiale: 3.1. bamirësia të bëhet për hir të Zotit dhe shpërblimi të pritët vetëm nga Ai, 3.2. të gjurmohen e të gjenden nevojtarët e vërtetë, 3.3. bamirësia të mos bëhet me gjësende që janë të pavlera e të dala nga përdorimi, 3.4. bamirësia të mos bëhet me kryelartësi si dhe të ruhet privatësia, nderi dhe dinjiteti i nevojtarit, 4. nevojtarët të mbështeten në atë mënyrë që në të ardhmen mundësisht vetë ta rregullojnë gjendjen e tyre, sipas parimit: të ndihmojmë, ta ndihmosh vetveten, të mos mbetesh përherë i varur prej të tjerëve dhe në fund mundësisht t'u ndihmosh edhe ti të tjerëve.

Kreuzlingen, 01.01.2022

## **Literatura e konsultuar:**

1. Kur'ani,
2. Përmbledhjet e haditheve,
3. Jusuf el-Karadavi, *Islam i siromaštvo*, Sarajevo 2003,
4. Mehmet Soysaldı, *Detyrat dhe përgjegjësitë e njeriut*, Tetovë 2021,
5. Scheherazade S. Rehman & Hossein Askari, "How Islamic are Islamic Countries?", *Global Economy Journal*, Vol. 10, Issue 2, 2010,
6. Yunus Vehbi Yavuz, *Çalışma Hayatı ve İslam*, İstanbul 1992.